



**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M
Nr. 3, datë 03.12.2020

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA VLORË,

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr.686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 1, datë 16.10.2017 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Vlorë”, Vendim Nr. 4, datë 17.05.2019 të KKT-së “Rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Vlorë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 79, datë 29.10.2020, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Vlorë të miratuar me Vendimit Nr. 1, datë 16.10.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe të ndryshuar me Vendim Nr. 4, datë 17.05.2019, të bëhen ndryshime në dokumentin e:
 - 1.1. Planit të Zhvillimit të Territorit, në:
 - *Pikën 1.11 “Përcaktimi i zonave / njësive, ku do të zbatohen instrumentet për drejtimin e zhvillimit dhe zbatimin e PDV-ve”;*
 - *Hartën Nr. 20, “Instrumentet e Zhvillimit të Propozuar”, sipas Shtojcës I.*
 - 1.2. Hartën e Rrjetit Rrugor të Propozuar, sipas Shtojcës III.
 - 1.3. Rregullores së Planit, në:
 - *Nenin 18 “Nënkategoritë e kategorisë bazë të përdorimit të tokës”;*
 - *Nenin 21 “Kategoritë e lejuara të përdorimit të tokës dhe strukturave në të”;*
 - *Nenin 27 “Treguesit dhe rregullat për zonat, njësitë strukturore në Sistemin Urban”;*
 - *Nenin 45 “Treguesit e zhvillimit në zonat që nuk janë subjekt i Planeve të Detajuara Vendore”;*
 - *Nenin 49 “Përcaktimi i instrumenteve të aplikueshëm për drejtimin e zhvillimit dhe zbatimin e PDV-ve”;*
 - *Nenin 54 “Ristrukturimi i strukturave ekzistuese”;*
 - *Seksionin “Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore”.*

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Vlorë bashkëlidhur këtij Vendimi.



2. Ngarkohen Bashkia Vlorë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.


MINISTR

3. Ngarkohen Bashkia Vlorë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

